


Letër familjes


I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në Kapitullin 2, do të fillojmë të studiojmë gjeometrinë tripërmasore (stereometrinë), duke përfshirë këtu edhe matjen e sipërfaqes dhe të vëllimit. Do të ndërtojmë modele tripërmasore dhe do t'i përshkruajmë me fjalë ose me shprehje algjebrike. Do të përdorim gjithashtu blloqe për të ndërtuar struktura komplekse që u përgjigjen vizatimeve dypërmasore, si dhe do të bëjmë vizatime për të përshkruar strukturat që ndërtojmë.

Ja një shembull i një modeli gjeometrik me blloqe, që do të ndërtojmë. Do të identifikojmë rregullsinë në model dhe pastaj do të përcaktojmë sa kube do të duhen për fazën 4, fazën 5 dhe kështu me radhë.



Një mënyrë tjetër për ta vizatuar këtë model është edhe e ashtuquajtura *pamje nga lart*. Mundohuni të përfytyroni modelin të kqyrur nga lart poshtë. Tri *pamjet nga lart* do të duken si në vijim. Numrat në vizatim tregojnë sa blloqe ka për çdo radhë në stivë.



Më në fund, do të përpiqemi të gjejmë sa blloqe do të ketë në fazën 93, në rast se në fazën 92 ka 8.464 blloqe.

Fjalor Gjatë këtij kapitulli, do të njihemi me këta terma të rinj:

bazë
cilindër
rrjetë

prizëm
sipërfaqe
vëllim

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Kur t'i afrohem fundit të Kapitullit 2, ju dhe fëmija juaj mund të zbaviteni duke mbledhur kuti të ndryshme (konservash etj.) dhe duke u përpjekur të merrni me mend vëllimin për secilën. Pastaj llogariteni vëllimin real dhe krahasojeni rezultatin me ç'kishit marrë me mend. Cili prej jush parashikoi më mirë?

